

Prokuroria jep detaje rreth përleshjes në "Bon Vivant": 7 të plagosur nga arma zjarrit

KRONIKA | August 05, 2023 - 16:55

SHPËRNDAJE:

Prokuroria Themelore në Prishtinë ka dhënë detaje rreth përleshjes së të premtes që ndodhi lokalin "Bon Vivant" në Prishtinë.

Sipas Prokurorisë, është konstatuar se nga arma e zjarrit kanë rezultuar të plagosur 7 persona, ku njëri nga ta si pasojë nga plagët e marra ka ndërruar jetë në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës.

"Më datën 04.08.2023 në orët e mbrëmjes, prokurori kujdestar i Prokurorisë Themelore në Prishtinë është njoftuar nga ana e Policisë së Kosovës, që në rrugën 'Reshep Luci' në Prishtinë respektivisht në lokalin 'Bon Vivant', ka të shtëna me armë zjarri. Me të marrë informacioninin, prokurori i shtetit bashkë me njësitet relevante të Policisë së Kosovës, ka konstatuar se si pasojë e të shtënave ka persona të plagosur", thuhet në komunikatën e Prokurorisë.

"Është konstatuar se nga arma e zjarrit kanë rezultuar të plagosur 7 persona, ku njëri nga ta si pasojë nga plagët e marra ka ndërruar jetë në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës. Ndërsa 13 persona të tjerë kanë pësuar lëndime trupore nga gërvishtjet e shamave apo nga gjësendet tjera. Të gjithë kanë kërkuar ndihmë mjekësore", thuhet tutje.

Prokurori i rastit në bashkëpunim me Policinë e Kosovë janë duke punuar në drejtim të identifikimit të personave të implikuar në këtë rast me qëllim të zbardhjes së plotë të ngjarjes, është marr aktvendim mbi ndalim ndaj disa personave.

"Prokurori, rastin në fjalë e ka cilësuar 'Vrasje të rëndë' neni 173, 'Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve' neni 366 dhe 'Pjesëmarrje në rrahje' neni 187 i Kodit Penal të Kosovës", thuhet tutje.

"Ajo që është më rëndësi të ceket se një person gjendet në arrati, ndërsa është konstatuar se gjithë të dyshuarit kanë të kaluar kriminale", thekson Prokuroria.

TabOola Feed



Një produkt i harruar që mund të pastrojë enët e gjakut.
Si të pastrosni enët e gjakut dhe të ulni kolesterolin
Krysekardiologu i Shqipërisë | Sponsored
Lexo më shumë

Lovely Thong Underwear Sets. See Prices
Thong Underwear Sets | Search Ads | Sponsored

Haradinaj kërkon krijimin e menjëhershëm të Policisë së Prishtinës pas incidentit të mbrëmshëm në "Bon Vivant"
Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj ka reaguar pas përleshjes me armë zjarri që ka ndodhur mbrëmë, ku një person ka ndërruar jetë dhe 17 tjerë kanë...
Zeri.info

Interested in investing? Cyprus offers many options
Cyprus Invest | Search ads | Sponsored

Albania Solar Panels: See How Much It Will Cost To Install Them (See Prices)
Solar Panels | Search Ads | Sponsored

Roofing Jobs In USA: Salaries In 2023 May Surprise You
Don't Waste Your Time, Apply Today!
Roofing Job | Search Ads | Sponsored
Search Now



Pacolli: Dy shtete të mëdha do ta njohin Kosovën
Kryetari i Alleancës Kosova e Re Behgjet Pacolli, ka thënë se shumë shpejt Kosovën do ta njohin dy shtete të mëdha. Pacolli tha se emrat e këtyre shteteve do të bëhen publike në dëtët...
Zeri.info

Live Like a King in the Heart of Dubai: Luxury Apartments for Sale
Dubai Apartments | Search Ads | Sponsored
Search Now

Të rekomanduara

Prokuroria jep detaje rreth përleshjes në...

August 05, 2023

Nëntë e bijë nga Kosova vdesin në një...

August 05, 2023

Arrestohet edhe një serb për krime lufte ndaj popullësisë civile në Istog
KRONIKA | August 05, 2023

Sot varroset 39-vjeçari që vdiq pasi u plagos mbrëmë në "Bon Vivant"
KRONIKA | August 05, 2023

Pamje nga përleshja e armatosur që ndodhi në Prishtinë
KRONIKA | August 05, 2023

FSK-ja konfirmon se një pjesëtar i tyre është përfshirë në ngjarjen tragjike në "Bon Vivant"
KRONIKA | August 05, 2023

I dyshuari për përfshirje në rastin e "Bon Vivantit" mbrëmë, i kërkuar edhe nga FBI-ja
KRONIKA | August 05, 2023

Policia lëshon urdhër për ndalim ndaj "Italianit", dyshohet për përfshirje në incidentin e mbrëmshëm në "Bon Vivant"
KRONIKA | August 05, 2023

Më të lexuarat

KRONIKA | August 04, 2023
Tatuazhi kundër Policisë i Krivaqës në ditën që u dënua me burgim të përjetshëm

KRONIKA | August 04, 2023
Xhaxhai i Marigona Osmanit Arbër Sejdiut: Shihemi pas 15 vjetësh

KRONIKA | August 05, 2023
Sherri me armë te Bon Vivanti, një person në gjendje të rëndë, i plagosur edhe një një sigurimi

KRONIKA | August 05, 2023
Kush është "Italiani" i përfshirë në vrasje e plagosje nëpër kafenetë e Prishtinës?

KRONIKA | August 05, 2023
Detaje të reja nga incidenti në "Bon Vivant", 14 femra u lëenduan, Policia në kërkim të një të dyshuari

KRONIKA | August 03, 2023
Vdes një 18-vjeçare në Prishtinë, na nga lartësia e një ndërtese

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara © 2010 Portali "Zëri".

redaksia@zeri.info
marketingu@zeri.info
Tel. + 383 38 24 90 71
Tel. + 383 38 22 24 51

Dev: **S.A.P** - Design: **Trembelat**

Ky portal mirëmbahet nga NGB "Zëri" sh.p.k.. Materialet dhe informacionet në këtë portal nuk mund të kopjohen, të shtypen ose të përdoren në çfarëdo forme tjetër pë qëllime përfitimi, pa miratimin e drejtuesve të "Zërit". Për ta shfrytëzuar materialin e këtij portali, obligohemi t'i pranoni Kushtet e përdorimit.